

Gjykata e Qarkut ne Mitrovicë
P. nr.31/09
27 Maj 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Charles Ll. Smith III si gjyqtar kryesues, dhe gjyqtarët e EULEX-it: Hajnalka Veronika Karpati dhe Nicolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues, të asistuar nga zyrtarja juridike e EULEX-it Tara Khan si proces-verbal mbajtëse, në lënden penale kundër

R. R. dhe **A. V.**, të akuzuar sipas aktakuzës PP nr.231/09 të prokurorit publik të Qarkut, Zjazi Rexha, të datës 11 shtator 2009 e të depozitar në Gjykatën e Qarkut më 14 shtator 2009, për trafikim me njerëz në kundërshtim me nenin 139, paragrafi (1), të Kodit penal të Kosovës (KPK) në bashkim me nenin 23 të KPPK-së;

Pas mbajtjes së gjykimeve të shqyrimit kryesor me 24,25,26, dhe 27 maj 2010, të gjitha në praninë e të akuzuarve **R. R.** dhe **A. V.** dhe avokatëve të tyre mbrojtës R. K. dhe F. B., prokurorit publik të EULEX-it Neeta Amin dhe B. M. si përfaqësues ligjor i palës së dëmtuar **Xh.Z.**;

Pas mbajtjes së shqyrimit për vendim-marrje të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur me 27 maj 2010, në bazë të nenit 392, paragrafi (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPK), shpalli publikisht dhe në praninë e të akuzuarve, mbrojtjes, prokurorit publik të EULEX-it Amin dhe përfaqësuesit ligjor B. M., këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **R. R.** me pseudonimin “...” i biri i ... dhe .., i lindur me ... në ..., Kosovë, shqiptar i Kosovës, ..., i martuar, ka tre fëmijë, në paraburgim që nga 19 qershor 2009 e deri me 15 shtator 2009 e pastaj nën arrest shtëpiak deri me 1 shkurt 2010,

Dhe

E akuzuara **A. V.** me pseudonimin “...” e bija e ... dhe ..., e lindur me ... në fshatin, ..., Republika e Shqipërisë, shtetase e Shqipërisë, ..., e divorcuar, ka dy fëmijë, nuk ka dënim më të hershëm, në paraburgim që nga 19 qershor 2009 deri me 21 prill 2010, tani për tanë nën masën e raportimit që duhet kryer në stacionin e policisë së Kosovës,

SHPALLEN TË PAFAJSHËM

Sepse nuk ka prova se nga fillimi i 2008 deri me 12 korrik 2009, **R. R.** dhe **A. V.** e kanë rekrutuar bashkarishët Sh. J.që të punojë në kafenenë Q., duke e shoqëruar **A. V.** dhe duke u ulur

me mushterinjë meshkuj, duke porositur pije të shtrenja në mënyrë që të rrisin profitin material të kafenesë. Gjithashtu nuk ka prova se **R. R.** e ka rekrutuar **Xh. Z.** me mashtrim duke i ofruar asaj punë si kamariere në kafenenë Q., pastaj duke i gjetur mushterinjë meshkuj për eksplorim seksual me qëllim të përfitimit material.

Prandaj të akuzarit **R. R.** dhe **A. V.**

Lirohen

Ngaakuza se kane kryer veprën penale të trafikimit me njerëz në shkelje të nenit 139, paragrafi (1) të KPPK-ës, në bashkim me nenin 23 të KPPK-ës.

Pasaporta e A. V.jt do t'i kthehet në bazë të nenit 251 të KPPK-ës.

Në bazë të nenit 103, paragrafi (1) të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale nën nenin 99, paragrafi 2, pikat (1) deri (5) të KPPK-ës, shpenzimet e nevojshme të akuzuarve, pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës, si dhe shpenzimet e përkthimit do të paguhen nga burimet buxhetore.

ARSYETIM

A. Rethanat procedurale

Prokurori publik i Qarkut Nijazi Rexha ka depozituar pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me 14 shtator 2009 aktakuzën PP nr.231/09 të datës 11 shtator 2009. Aktakuza e akuzon **R. R.** dhe **A. V.** për vepër penale të trafikimit me njerëz në kundërshtim me nenin 239, paragrafi (1), së bashku me nenin 23 të Kodit penal të Kosovës. Aktakuza është konfirmuar më 29 dhjetor të vitit 2009 me anë të aktvendimit KA nr.75/09. Prokurori publik i EULEX-it Neeta Amin e mori përsipër rastin dhe depozitoi kërkesë që gjyqtarët e EULEX-it ta shqyrtojnë lënden. Gjyqtarët e EULEX-it e morën përsipër lënden me 15 shkurt të 2010. Shqyrtimit kryesor u mbajt me 24, 25, 26 dhe 27 maj 2010.

Fjalët përfundimtare të prokurorit të EULEX-it Neeta Amin, përfaqësuesit të palës të dëmtuar **B. M.**, të avokatit mbrojtës R. K. (për **R. R.**), dhe avokatit mbrojtës F. B. (për **A. V.**) u dëgjuan më 27 maj 2010. Po të njejtën ditë u lëshua dhe aktgjykimi me gojë.

B. Kompetenca e Gjykatës

Sipas nenit 23, pika (1) (i) të KPPK-së, gjykatat e qarkut janë kompetente për t'i shqyrtuar lëndet penale që kanë të bëjnë me akuzat për të cilat ligji parashevë dënimin penal prej së paku 5 viteve. Në bazë të nenit 27, paragrafi (1) të KPPK-së, jurisdikzioni territorial i takon asaj gjykate në qarkun e të së cilës pretendohet se është kryer krimi.

Të akuzuarit akuzohen për vepër penale të trafikimit me njerëz sipas nenit 139, paragrafi (1) të KPPK-së i cili është i dënushëm me dënim burgu prej dy deri dyshëdhjetë vite, për më tepër aktakuza pretendon se dy të akuzuarit i kanë kryer veprat penale në Vushtrri vend ky i cili gjendet në Qarkun e Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës është organ kompetent gjyqësor që të merret me shqyrtimin e kësaj procedure penale. Me 15 shkurt 2010, kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, ka lëshuar vendim që EULEX-i ta marrë përsipër këtë rast duke u bazuar në nenin 3.3 të Ligjit mbi jurisdikcionin, selektimin dhe ndarjen e rasteve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it (Ligji mbi jurisdikcionin) dhe ua caktoj këtë lëndë gjyqëtarve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Prandaj gjyqtarët e EULEX-it të caktuar pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë janë kompetentë që ta gjykojnë këtë rast penal.

Trupi gjykues përbehej prej gjyqtarëve të EULEX-it, Charles Ll. Smith, III si gjyqtar kryesues, dhe gjyqtarët e EULEX-it: Hajnalka Veronika Karpati dhe Nicolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues. Asnjëra palë nuk pati kundërshtim lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

C. Dëshmite që janë paraqitur

Gjatë gjykimit kryesor u dëgjuan këta dëshmitarë:

1. **Sh. J.** (Palë e dëmtuar) me 25 Maj 2010
2. **N. K.** me 25 Maj 2010
3. **F. B.** me 26 Maj 2010
4. Policia **L. H.** me 26 Maj 2010

Me 26 maj 2010, këto dokumente u shënuan në procesverbal:

5. Deklarata e palës së dëmtuar **Xh. Z.** e datës 12 qershori 2009.
6. Deklarata e palës së dëmtuar **Xh. Z.** e datës 16 qershori 2009.
7. Deklarata e palës së dëmtuar **Xh. Z.** e datës 13 korrik 2009.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 26 maj 2010, të dytë edhe **R. R.** edhe **A. V.** dhanë deklaratë dhe iu përgjigjën pyetjeve.

1. Dëshmia e palës së dëmtuar Shqipe Jashari

Shqipe Jashari ka dëshmuar se e ka takuar **R. R.** dhe **A. V.** kur **A. V.** kishte marrë me qira një dhomë në po të njëjtën shtëpi ku edhe **Sh. J.** kishte një dhomë me qira. Ajsha ishte prezantuar te Shqipja si “Elvana”. **A. V.** i kishte thënë Shqipe Jasharit se ishte nga Shqipëria, se kishte punuar tek Rushiti si kamariere në kafenenë e tij të quajtur “afe Q.”, dhe se ajo ishte në marrëdhënje me Rushitin. **A. V.** i kishte thënë **Sh. J.** se ishte e mërzitur dhe ishte e vetmuar dhe se kishte nevojë për një shoqe. **A. V.** e kishte ftuar **Sh. J.** që ta vizitojë atë në kafenë Q. disa herë. **Sh. J.** kishte shkuar në kafenenë “Q.” dy apo tri herë. **Sh. J.** ka dëshmuar se kur ishte në kafe, ishte ideja dhe sugjerimi i **A. V.** që **Sh. J.** të ulej me klientë meshkujë të cilët ishin mushterijë të rregullt të kafenesë dhe të porosiste pije së bashku me ta. **Sh. J.** është ulur me mushterijë

meshkuj disa herë të cilët nuk i njihte dhe ata i kishin porositur asaj pije¹. **Sh. J.** u prezantohej klientëve si shoqe dhe vizitore². Kishte dhe raste herë pas here kur **Sh. J.** nuk kishte dëshirë të ulej me mushterijë meshkuj në kafe, porse ose **A. V.** ose **R. R.** i thonin asaj që të mos frikësohej dhe të ulej me ta sepse ata ishin mushterijë të rregullt dhe pijet ishin gratis³.

Gjatë një rasti në kafene, Shqipe Jashari i kishte dëgjuar pahiri **A. V.** dhe **R. R.** se do të fitonin më shumë nëse Shqipe Jashari do të ulej me mushterijë. Në po atë rast, **A. V.** dhe **R. R.** e kishin pyetur **Sh. J.** mos ishte e interesuar të punonte në kafe si kamariere. Që të dytë, edhe **A. V.** dhe **R. R.** i kishin thënë **Sh. R.** se nëse punon aty, ata do ta kishin fitimin më të madh nëse do të ulej me mushterijë për të porositur pije⁴. Ata i kishin thënë asaj se nëse punon në kafene do të merrte 150 euro në muaj dhe banimin do ta kishte falas në banesën mbi kafenë “Q.” cila ishte pronë e **R. R.** **Sh. J.** ju kishte treguar prindërve të saj për atë ofertë të punës dhe se babai i saj i kishte telefonuar **Sh. J.** duke i thënë atij që t’i rrij larg **Sh. J.**.

Sh. J. ka dëshmuar se nuk kishte punuar kurrë në atë kafe, se nuk kishte marr kurrë ndonjë pagesë për atë se ishte ulur me mushterijë meshkuj në kafe dhe se nuk kishte marr kurrëfare të hollash as prej **R. R.** e as prej **A. V.** **Sh. J.** gjithashtu ka dëshmuar se nuk e ka njojur **Xh. Z., N. K.** e as **F. B.**.

2. Deklaratat e palës së dëmtuar Xh. Z.

Pala e dëmtuar **Xh. Z.** nuk është paraqitur ne gjykatë në asnjë seancë edhe përkundër asaj se ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Sipas prokurorit publik dhe policisë së Kosovës **Xh. Z.** nuk jetonte më në shtëpinë e saj dhe përpjekjet për ta gjetur atë ishin të pasuksesshme. Për shkak të zhdukjes së saj, gjykata i kishte futur në procesverbal si të lexuara tri deklaratat e saj të mëhershme të bëra në polici dhe te prokurori sipas nenit 360, paragrafi (1), pika (1).

*Me 12 qershor 2009, **Xh. Z.** në polici kishte deklaruar si vijon:*

Xhejlane Zajmi kishte qenë duke punuar si kamariere në Kafe Q. pronë kjo e **R. R.** që nga 9 qershori 2009 dhe atë për 6 euro në ditë. Ajo ishte marrë vesh me **R. R.** se do të kryente marrëdhënje seksuale me njerëz që ai do ja sillte asaj. Personi do të paguante 20 euro për seks, 10 euro do i shkonin **Xh. Z.** kurse 10 euro R. R.t. Me 9 qershor 2009 përafërsisht në ora 21.30, një person kishte folur me **R. R.** dhe ishin marr vesh se ai do të bënte seks me **Xh. Z.** për të holla. **Xh. Z.** kishte shkuar me personin në banesën e tij cila gjindej afér akademis policore dhe kishte bërë seks gjatë një ore, gjë për të cilën ajo kishte marrë 10 euro kurse **R. R.** kishte marr dhe ai 10 euro. Të nesërmen, një person tjetër ishte takuar me **R. R.** për të njejtën arsy, mirëpo **Xh. Z.** kishte refuzuar të bënte seks me atë person. Më 12 qershor 2009, **Xh. Z.** ishte në Kafe Q. në ora 20.40 kur një zënkë kishte shpërthyer mes dy mushterijëve, **A. B.** dhe birit të tij **F. B.**. **Xh. Z.** kishte refuzuar të bënte seks me **A. B.** dhe si rezultat i kësaj **F. B.** ia kishte ngjitur për dore asaj dhe ishte përpjekur ta godasë atë me një shishe birre. Rushiti kishte intervenuar ta mbrojë **Xh. Z.** dhe **Xh. Z.** kishte shkuar ne kuzhinë përderisa një rrahje kishte shpërthyer në mes

¹ Prosesverbali i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 16.

² Prosesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 9.

³ Prosesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 13-14 dhe 21.

⁴ Prosesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 13 dhe 20.

të burrave në kafe. Pastaj ajo kishte shkuar tek banesa e cila gjendje mbi kafene përderisa kishte ardh policia dhe e kishte marr atë në stacion.

Më 16 qershor 2009, Xh. Z. në polici kishte deklaruar si vijon:

Xh. Z. ishte në lidhje me Nexhat Kurtin për tri vite me radhë. Javën para se të jepte deklaratën e saj, **Xh. Z.** dhe **N. K.** kishin shkuar në Kafe Q. së bashku. **Xh. Z.** ishte marr vesh me **R. R.** që ajo të punoj si kamariere për 6 euro në ditë dhe banim falas. Ata gjithashtu ishin marrë vesh se ajo do të bënte seks me mushterinjë dhe se kështu ajo me **R. R.** do t'i ndanin të hollat për gjysmë. **N. K.** nuk ishte në dijeni për këtë marrëveshje. **Xh. Z.** kishte bërë seks me një mushterinjë me emrin A. të quajtur nga Prishtina në një banesë afér Akademisë së policisë. Këta kishin bërë seks një orë dhe ishin kthyer në kafe. Astriti ia kishte paguar **R. R.** të hollat për seks dhe ia kishte dhënë 10 euro **Xh. Z.** duke i thënë asaj “Mbaj këto të holla për seksin me Astritin”. Më 12 qershori 2009, **A. B.** dhe **F. B.** shkuan në Kafe Q. dhe **Xh. Z.** ishte ulur në tavolinë me ta. **A. B.** i kishte thënë **Xh. Z.** se ajo nuk kishte zgjidhje tjetër vec të bënte seks me të. Ajo kishte refuzuar dhe kështu **A. B.** kishte filluar ta shajë atë. Ajo ishte larguar nga tavolina e tyre dhe kishte shkuar të ulej tek **R. R.** dhe dashnorja e tij “E” (**A. V.**). **F. B.** ishte përpjekur pastaj ta godas **Xh. Z.** me një shishe birre kurse **R. R.** kishte ndërhyre. Rrahja kishte shpërthyer mes burrave. **Xh. Z.** kishte shkuar në banesën lartë përmbi kafe dhe kishte qëndruar aty së bashku me **A. V.** derisa kishte arritë policia.

Më 13 qershor 2009 Xh. Z. para prokurorit publik kishte deklaruar si vijon:

Xh. Z. ka deklaruar se i kishte kaluar 4-5 ditë në Kafe Q. me shoqen e saj **A. V.**. Gjatë asaj kohe, ajo kishte kaluar kohën dhe në kafene dhe në banesën përmbi të, duke pasur biseda shoqërore me **A. V.** dhe **R. R.**. As **A. V.** e as **R. R.** nuk i kishin afruar kurrë punë në kafene. **Xh. Z.** nuk kishte pasur kurrë seks me mushterinj, ajo nuk kishte pasur kurrë seks me një person të quajtur A. nga Prishtina, dhe se **R. R.** nuk i kishte dhënë kurrë asaj të holla pas sekshit me mushterinjë. **Xh. Z.** nuk kishte thënë të vërteten në dy deklaratat e saj të mëhershme të dhëna në polici sepse kishte qenë nën presion që ta cekë policën **L. H.**.

3. Dëshmia e F. B.

F. B. ka dëshmuar se ka shkuar shpesh në Kafe Q., dy apo tri herë në javë dhe se **A. V.** të cilën **F. B.** e njihte si “E.” punonte aty si kamariere. Ai kishte qenë në Kafe Q. në natën e 12 qershorit 2009, pronari **R. R.** dhe **A. V.** kishin qenë të pranishëm. **F. B.** e kishte parë babain e vetë **A. B.**, fqjun e tij **Sh. M.**, dhe **Xh. Z.** të ulur së bashku duke pirë pije në një tavolinë. **F. B.** ka deklaruar se **Xh. Z.** ishte nën ndikimin e alkoholit dhe se ajo e kishte shërbyer atë me pije. Megjithatë, ai nuk e kishte ditur se a punonte ajo aty si kamariere. **XH. Z.** ishte ulur me të në një tavolinë përafërsisht 10 minuta. Kishte pasur një bisedë me të dhe kishin pirë nga një pije. Në po atë mbrëmje, **F. B.** dhe një mushteri tjetër me emrin B. ishin zënë sepse ishin nën ndikim të alkoholit dhe i kishin thyer karrigat. Në momentin e zënkës, **XH. Z.** qëndronte e ulur në një tavolinë me B. dhe I.. **F. B.** ka dëshmuar se nuk e njeh **Sh. J.** apo personin e quajtur A..

4. Dëshmia e N. K.

N. K. ka dëshmuar se e kishte takuar **Xh. Z.** për herë të parë 3-4 vite më herët kur ajo vinte si mushteri në ëmbëltoren e tij dhe më vonë ishin bërë dashnorë. Herë pas here **N. K.** dhe **Xh. Z.** kishin shkuar për të pirë në Kafe Q.. **N. K.** ka dëshmuar se **A. V.** i kishte kërkuar Xhejlane

Zajmit të qëndrojë me të në banesën përmbi Kafe Q. sepse **A. V.** frigohej të flinte vetë aty. **Xh. Z.** kishte qëndruar me **A. V.** vetëm një herë por kishte qëndruar për një periudhë dy deri tri ditë. Sipas **N. K.**, **Xh. Z.** ishte shumë mirënlohëse ndaj **A. V.** për arsy se kjo i kishte ndihmuar asaj dhe i kishte dhënë asaj rroba dhe ushqim. **Xh. Z.** nuk ka punuar kurrë në Kafe Q., ajo ka qenë aty vetëm mushteri. **N. K.** ka dëshmuar se nuk e njef personin me emrin A. dhe se kishte parë **Sh. J.** vetëm një herë më herët.

5. Dëshmia e Luljeta Halilit

L. H. është police e cila punon në hetimet që kanë të bëjnë me trafikim me njerëz. Ajo e kishte intervistuar palën e dëmtuar **Xh. Z.** më 16 qershor 2009 së bashku me kolegut e saj **F. R. B. M.i**, avokat i **Xh. Z.**, ishte i pranishëm gjatë asaj interviste. Policia nuk kishte përdorur ndonjë presion mbi **Xh. Z.** dhe se ajo e kishte dhënë deklaratën e saj me dëshirë. As **Xh. Z.** e as **Xh. Z.** nuk kishin cekur ndonjë ankesë në lidhje me intervistën apo të kenë thënë se intervista ishte zhvilluar në mënyrë të padrejtë apo të gabueshme. Pas përfundimit të intervistës, policia ia kishte lexuar deklaratën përsëri **Xh. Z.**, dhe **Xh. Z.** e kishte nënshkruar atë pa presion. Sipas mendimit të **L. H.**, **Xh. Z.** dukej si viktimi e vërtetë gjatë intervistës. Policia **L. H.** më vonë u informua nga prokurori se avokati mbrojtës së bashku me gruan e **R. R.** kishin shkuan te shtëpia e **Xh. Z.** dhe i kishin kërkuar asaj që ta ndryshonte deklaratën e vet.

6. Dëshmia e dy të akuzuarve

Dëshmia e R. R.

R. R. e kishte takuar **A. V.** në maj 2008. Ai e kishte ftuar atë të punojë si kamariere në Kafe Q. për 10 euro në javë, një shujtë në ditë dhe banim falas. Ajo ishte pajtuar dhe kishte kaluar në banesën përmbi kafene. Pas një kohe kishin filluar dhe lidhjen e tyre. **R. R.** e njeh **N. K.** dhe dashnoren e tij **Xh. Z.. N. K.** dhe **Xh. Z.** kishin shkuan në Kafe Q. me 9 qershor 2009 për të pirë. **Xh. Z.** kishte qëndruar me **Xh. Z.** disa ditë sepse **Xh. Z.** ndihej e vëtmuar dhe kishte frigë. Me 12 qershor 2009, **Xh. Z.** po pinte së bashku me **F. B.** dhe **A. B.** në kafene. Ata kishin konsumuar shumë alcohol kurse **A. B.** kishte deklaruar se Xhejlane Zajmi ishte shoqja e tij. Rushiti e kishte dëgjuar pahiri **A. B.** duke i thënë **Xh. Z.**: “a të kujtohet kur ti kam këput taket e nalta edhe ta kom fut kryet nën ujë dhe tu mbushke fytì ujë”? **A. B.** i kishte thënë **R. R.** kishte qenë femra e tij për një kohë të gjatë.

Përkitazi me dëshminë e **Sh. J.**, **R. R.** e ka mohuar se **A. V.** e ka sjellur **Sh. J.** që të punojë për të, se ai kurrë nuk ka deklaruar se do të kishte fitim më shumë pot e ulej Shqipe **Sh. J.** me mushteri, se kurrë nuk e kishte udhëzuar **Sh. J.** që të ulej me mushterijtë e tij ose që kurrë nuk i ka dhënë të holla **Sh. J.**.

Sa i përket dy deklaratave të Xhejlane Zajmit dhënë në polici, **R. R.** e ka mohuar kategorikisht se **Sh. J.** ka punuar për atë si kamariere në Kafe Q., se kurrë nuk i ka thënë **Xh. Z.** ti ofroj shërbime seksuale ndokujt, se kurrë nuk ia ka shitur **Xh. Z.** ndokujt apo që i ka dhënë ndonjëherë të holla **Xh. Z.. R. R.** gjithashtu e ka mohuar ta ketë njohur ndonjë person me emrin A..

Xh. Z. ka dëshmuar se përderisa gjindej në paraburgim gruaja e tij e kishte pyetur **Xh. Z.** se mos **R. R.** e kishte shitur atë dhe se **Xh. Z.** ishte përgjigjur “jo”. **Xh. Z.** pastaj i kishte thënë gruas së tij se e kishte akuzuar **R. R.** për shkak se “ajo kishte qenë e shqetësuar dhe e rrahuar në

Mitrovicë” pastaj **Xh. Z.** vullnetarisht i ka tërhequr deklaratat e saja të mëhershme të dhëna në polici.

Dëshmia e A. V

A. V. ka dëshmuar se ajo po punonte si kamariere në Prishtinë kur e kishte takuar **R. R..** Ajo kishte shkuar të punojë si kamariere për të në Vushtrri për arsyen se paga ishte më e mirë. Ajo dhe **R. R.** filluan të kalonin. **A. V.** ka punuar në Kafe Q. si kamariere për një vit përafërsisht për 10 euro në ditë. Pastaj ajo u largua dhe shkoi në Prishtinë për një muaj, **R. R.** i kishte paguar qiranë e banesës dhe ajo takoi **Sh. J..** Pas një muaji, **A. V.** u kthye në Vushtrri.

Sa i përket Shqipe Jasharit, **A. V.** ka dëshmuar se **Sh. J.** kishte ardhë ta vizitojë atë në Vushtrri për dy tri ditë dhe me vullnetin e saj. **A. V.** e ka mohuar ti ketë thënë **Sh. J.** se kishte frigë të qëndroj në banesë vetëm. Kur **Sh. J.** kishte shkuar të qëndroj tek ajo, ajo ishte ulur nepër tavolina në Kafe Q. dhe ishte ulur me shokët e saj dhe jo me të huaj. **A. V.** e ka mohuar që ajo dhe **R. R.** t'i kenë thënë Shqipe Jasharit se ajo duhet gjithashtu të punojë në kafe apo se ajo dhe Rushiti kishin diskutuar faktin se nëse **Sh. J.** ulet nepër tavolina fitimi do të ishte më i madhë. **A. V.** gjithashtu e ka mohuar ta ketë rekrutuar **Sh. J.** me qëllimin që ajo të bëj seks me mushterijtë meshkuj.

Sa i përket **Xh. Z., A. V.** ka dëshmuar se e ka njojur **Xh. Z.** vetëm disa ditë. **A. V.** e njihte atë si dashnore të **N. K..**

A. V. ka deklaruar se nuk ka qenë e involvuar në ngjarjet që kishin ndodhur ne Kafe Q. në qershor të vitit 2009. Në atë natë ajo e ka parë **Xh. Z.** duke pirë alcohol në kafenenë Q.. **A. V.** ka qenë lartë në banesë duke shikuar televizionin kur ka ndodhur incidenti dhe kur policia ka ardhur në kafe. **A. V.** e ka mohuar ta ketë njojur ndonjë person me emrin **A..**

D. Vlerësimi i dëshmive të paraqitura

Besushmëria e dëshmitarëve

Gjykata ka gjetur se deshmia e dëshmitarës **Sh. J.** është e besueshme dhe konsistente dhe si e tillë e përshkon përbajtjen e përgjithëshme të dëshmisë së saj. Gjykata ka gjetur se edhe dëshmia e **N. K.** është e besueshme. Meqenëse ai nuk ka qenë dëshmitar në asnijëren prej veprimeve kriminale për të cilat pretendohet se janë kryer dhe meqenëse ka pasur informata të kufizuara përkizazi me veprimet e **Xh. Z.** apo **Sh. J.** lidhje me Kafen Q. dëshmia e tij nuk ka shtuar asgjë të re në këtë rast.

Gjykata gjithashtu ka gjetur se dëshmia e policës **L. H.** është e besueshme. Policia **L. H.** ishte e qartë dhe e drejtëpërdrejt gjatë dëshmis që po e jepte lidhur me zhvillimin e ligjshëm të të dy intervistave policore të **Xh. Z..** Deklarata e **L. H.** përforcohet dhe mbështetet në faktet se: deklarata e 12 qershorit e përmban deklaratën me nënshkrim të **Xh. Z.** si deklaratë të vërtetë dhe të saktë e cila nuk është dhënë në asnje ndikim ose presion. Intervista e 16 qershorit 2009 është zhvilluar në pranin e avokatit **B. M.** si përfaqësues ligjor i **Xh. Z.**, edhe deklarata e intervistës të 16 qershorit 2009 përmban deklaratën me nënshkrimin e **Xh. Z.** se deklarata i është lexuar asaj me zë dhe nuk ka pasur vërejtje. Për këto arsyen gjykata nuk ka arsyen të dyshoj në ligjshmërin e

intervistave dhe se deklaratat me shkrim janë reflektim i saktë i asaj se cka ka thënë dëshmitarja para policisë.

Megjithatë, vërtetësia e deklaratave të **Xh. Z.** nuk mund të vërtetohet nga gjykata. Egziston kontradiktë evidente e drejtëpërdrejtë në mes të deklaratve të dhëna në polici dhe deklaratës së 13 korrikut 2009 para prokurorit publik. Përvec kësaj, madje ka edhe mospërputhje në mes të dy deklaratve të dhëna në polici në qershor 2009. Po të ishte paraqitur **Xh. Z.** në gjykatë dëshmia e saj do ta kishte ndriuar besueshmërin e njërit apo tjetrit version të deklaratave. Por meqenëse ajo nuk është paraqitur në gjykatë, ka qenë e pamundshme për gjykatën që ta vlerësojë besushmërin e dëshmitares dhe se gjykata nuk ka mundur të arrij te asnjë konkludim sa i përket vërtetësisë së njërsë prej tri deklaratve të **Xh. Z.**. Prandaj, aspektet e deklaratave cilat janë kontradiktore duhet të shikohen në bazë të asaj se cila është më e favorshme për të akuzuarit.

2. Konstatimi i gjendjes faktike

Në bazë të dëshmive që janë paraqitur gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor gjykata mund ti konsideroj si të dëshmuara vetëm këto fakte:

A. V. ka punuar si kamariere në kafenenë Q., pronë kjo e **R. R. A. V.** ka jetuar në banesën cila gjindej mbi kafene. **A. V.** e ka takuar **Sh. J.** kur ajo ishte larguar nga Vushtrria dhe kur e kishte marrë një dhomë me qira në po të njëjtën shtëpi në Prishtinë. Pastaj, **A. V.** është kthyer në Vushtrri dhe **Sh. J.** ka shkuar ta vizitoj atë për disa ditë.

Gjkata beson se ka pasur bisedë në mes të **A. V.** dhe /ose **R. R.** me **Sh. J.** përkitazi me punën e saj si kamariere në kafene. Gjkata nuk është e bindur se kjo ka qenë ofertë formale pune. Për më tepër, dy të akuzuarit edhe po ti kishin kërkuar **Sh. J.** se mos dëshironte të punoj në kafe si kamariere, meqenëse nuk ka kurfarë prove që ndonjëri prej të akuzuarve është përpjekur ta rekrutoj ose ta marr **Sh. J.** për të punuar në ndonjë cilësi tjetër pos kamarires ky fakt nuk do të kishte kurrëfarë ndikimi në rezultatin e aktgjykimit.

Gjkata gjithashtu gjen se poashtu nuk ka ndikim në këtë rast apo në aktgjykim fakti se a i ka kërkuar **A. V. Sh. J.** që ta vizitoj atë sepse ishte e frikësuar apo se a e ka vizituar **Sh. J.** me vullnetin e saj. Me këtë nuk arrihet kurrëfare konstatimi sa i përket kësaj pike.

Përderisa ishte në kafenenë Q., **Sh. J.** është ulur nëpër tavolina dhe është shoqëruar me disa mushterinjë cilët kanë porositur dhe kanë paguar piye. Të akuzuarit e kanë ditur faktin se mushterijtë meshkuj do të hargjesin më shumë të holla në kafe, piye gjatë shoqërimit me **Sh. J.**.

Gjkata mendon se dy të akuzuarit e kanë pranuar se fitimi në kafene ishte më i madh ku **Sh. J.** ulej me mushterijtë. Sidoqoftë, një gjë e tillë nuk paraqet vepër penale meqenëse është e qartë nga dëshmia e **Sh. J.** se ajo ka pasur mundësin ta refuzoj ofertën e punës në kafe dhe se kurrë nuk ka qenë e detyruar me forcë të ulet dhe të shoqërohet me mushterijë. Gjatë dëshmis së **Sh. J.**, gjyqtarja Hajnalka Veronika Karpati e ka pyetur **Sh. J.** në detaje se a është përdorur forcë apo kërcnim kundër **Sh. J.** gjatë punës në kafene ose derisa po ulej me mushterijë në kafene dhe përgjigjeja ishte se Shqipe Jashari kurrë nuk është detyruar me forcë që ta bëj një gjë të tillë.

Në mbrëmjen e qershorit 2009, një rrahje kishte shpërthyer në kafenë Q. ku ishte involuar **F. B.** si rezultat i saj, policia ka shkuar në kafe dhe ka arrestuat **A. V.** Lidhur me këtë incident nuk ka qenë e mundur që të vërtetohen fakte të tjera. Arsyet e kësaj rrahje duke përfshirë aty se a ka

rrjedhur kjo si rezultat i refuzimit të **Xh. Z.** për të bërë seks me **A. B.**, këto arsyen nuk mund të vërtetohen për shkak të kontraditave në mes të deklaratve të **F. B.** dhe **R. R.** dhe të deklaratve të ndryshme të **Xh. Z.** (të cilat janë kundërthënese mes veti dhe në veteve dhe u mungon besueshmëria për arsyet që u dhanë më lartë).

E. Ligji/ kualifikimi ligjor

Aktet penale pretendohen se janë kryer në qershor 2009. Kodi penal i Kosovës ka hyrë në fuqi me 6 janar 2009 kështu që është ligj në fuqi. Sipas nenit 2, paragrafi (1) të KPPK-ës ligji që ka qenë në fuqi në momentin kur kryhet vepra penale duhet të zbatohet.

Të akuzuarit akuzohen me nenin 139, paragrafi 1 të KPPK-së, trafikim me njerëzit. Trafikim me njerëzit definohet me paragrafin (8) si “rekrutimi, transportimi, transferi, strehimi dhe pranimi i personave nëpermjet kërcnimit apo përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, të lajthitjes, të keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të marrjes apo dhënjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit”.

*Sa i përket palës së dëmtuar **Sh. J.***

Dëshmitë e paraqitura gjatë gjykimit e që u përmblodhën më sipër vërtetojnë vetëm se **Sh. J.** vullnetarisht ka shkuar në Kafe Q. ku dhe është ulur në tavolina me mushterijë meshkuj, është shoqëruar me ata dhe ka porositur pije. Siq u përshkrua më sipër nuk ka dëshmi që **Sh. J.** ka qenë e detyruar me forcë dhe e shtyer ta kryej ndonjërin prej këtyre akteve. Ajo gjithashtu dhe nuk ka pranuar kurrëfare pagese prej asnjërit të akuzuarve. Për më teper zgjerimi i veprave të **R. R.** dhe **A. V.** duket se është bërë përshkak të diskutimit të tyre apo pohimit se **R. R.** kishte fitime më të mëdha nga pijet kur **Sh. J.** shoqerohej me mushterijëtë meshkuj.

*Sa i përket palës së dëmtuar **Xh. Z.***

Përshkak të mosparaqitjes së **Xh. Z.** në gjykatë dhe mungesës së besueshmërisë të deklaratve të saja kundërthënese në polici dhe te prokurori dhe përshkak se nuk ka pasur prova tjera mbështetëse dhe sqaruese lidhur me pretendimet që në fillim i kishte bërë **Xh. Z.** lidhur me aktet seksuale janë këto pretendime të cilat nuk kanë mundur të dëshmohen:

- Se njëri prej të akuzuarve e ka shtyer me forcë ose detyruar **Xh. Z.** që të ketë marrëdhënje seksuale me ndonjë person.
- Se njëri prej të akuzuarve ka marr të hollat nga ndonjë person i cili ishte lëshuar në marrëdhënje seksuale me **Xh. Z..**
- Se njëri prej të akuzuarve i ka dhënë të holla **Xh. Z.** për të pasur marrëdhënje seksuale me ndonjë person.

Kështu nuk është vërtetuar apo konstatuar asnjëri nga *actus reus* të cilat janë kritere për kryerjen e veprës penale të trafikimit me njerëz ose të ndonjë vepër më të vogël penale i cili do të ishte i aplikueshëm sipas KPPK-ës.

Për këto arsyet trupi gjykues e ka lëshuar **A. V.** dhe **R. R.** nga akuza e trafikimit me njerëz në pajtim me nenin 390(3) të Kodit të procedurës penale të Kosovës.

F. Shpenzimet

Për shkak të lirimt të dy të akuzuarve, në bazë të nenit 103, paragrafi (1) të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale nën nenin 99, paragrafi 2, pikat (1) deri (5) të KPPK-ës, shpenzimet e nevojshme të akuzuarve, pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës, si dhe shpenzimet e përkthimit do të paguhen nga burimet buxhetore.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

P. nr. 31/09

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtësja:

Kryetari i Trupit Gjykues

Tara Khan

Charles L. Smith, III

Këshillë juridike:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë në formë të shkruar kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur kopja e këtij aktgjykimi është pranuar sipas nenit 398, paragrafi (1) të KPPK-së.

⁵ Në faqën e fundit të verzionit anglisht është shkruajtur gabimisht numri i landës, përderisa në versionin shqip janë përmendur emrat e anëtarëve te Trupit Gjykues, ndërsa në versionin anglisht nuk janë përmendur.